



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
**MIRATIMIN E RAPORTEVE TË MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË
KËQYRJES PASZGJEDHORE TË FLETËVE TË VOTIMIT, MATERIALIT
ZGJEDHOR DHE PAJISJEVE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK
(PEVN) TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË,
TË DATËS 25 PRILL 2021**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME
LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, dhe 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për mbikëqyrjen e procesit të këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të votave. Procesi i këqyrjes së mëpasshme ka për qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit zgjedhor dhe vlerësimit e numërimit të votave. Gjithashtu, pas procesit zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe pas konstituimit të organeve të zgjedhura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik të votave të përdorura në zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, të cilat u përdorën në KZAZ nr.40 në Tiranë për të gjitha qendrat e votimit të kësaj KZAZ-je. Procedura e këqyrjes dhe verifikimit u realizua në seanca publike dhe me pjesëmarrjen e vëzhguesve të subjekteve të interesuara.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të udhëzimit nr 15, datë 07.10.2021“Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, miraton raportet e propozuara nga Sekretari i Përgjithshëm.



II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Administrata e KQZ-së bazuar në udhëzimin nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, nga datat 14.10.2021 deri më datë 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore. Më datë 14.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përzgjedhi në mënyrë rastësore 519 QV që përfaqësonin 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ nga 5199 QV. Nga kjo listë nuk u përfshinë në përzgjedhjen rastësore QV të sekuestruara nga prokuroria, QV të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor, si dhe QV e KZAZ Nr. 40 të cilat ju nënshtruan procesit të verifikimit të saktësisë së sistemit të votimit dhe numërimit elektronik. Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 519 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje të cilët vlerësuan dhe administruan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit. Për KZAZ nr.40 procesi i verifikimit u shtri në të gjitha qendrat e votimit. Ky proces përfundoi më datë 02.11.2021 i cili vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e raporteve përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit, të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, si edhe për saktësinë e të dhënave të gjeneruara në mënyrë elektronike nga sistemi PEVN me rezultatet nga numërimi i fletëve të votimit të gjetura në kutitë e votimit.

RREGULLSIA E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NGA KQV

Në përgjithësi nga QV-të e këqyrura rezulton se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivelin mesatar 79% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore për të duke vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.

Nga tërësia e treguesve të performancës së KQV-ve për këtë kategori vendimmarrje, komisionet e qendrave të votimit kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në nivelin mesatar 86% të tyre.



U konstatua se në 11 KQV nuk kanë plotësuar LPM veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Niveli i përputhshmërisë jo domosdoshmërisht përputhet me numrin e Komisioneve të Qendrave të Votimit. Këta të fundit kanë kryer procedurat e marrjes së vendimeve dhe plotësimin e procesverbaleve të administrimit të QV-së dhe Librit të Protokollit të Mbledhjeve sipas përcaktimeve të neneve 36 e vazhdim të Kodit Zgjedhor.

Në, mesatarisht 93% të QV-ve, baza materiale është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit 11 / 2021 të KQZ-së.

U konstatua se në 21 KQV mungon ky dokument në kutinë e materialeve zgjedhore veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, i cili protokollon ankesat, kërkesat, dhe njoftimet drejtuar KQV-ve, regjistron në LPM vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara, regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie. Në këto kushte në mbështetje të fakteve të evidentuara nga procesi i këqyrjes rezulton se Sekretari i QV-së në këto 21 KQV nuk ka përmbushur kërkesën ligjore.

Në, mesatarisht, 82 % të QV-ve janë administruar raportet e identifikimit elektronik të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së e vulosur nga sekretari, janë administruar raportet e hapjes dhe të mbylljes së PEI-t si në kutinë e votimit dhe në kutinë e materialeve zgjedhore.

Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme rezultoi se votat e pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

- 41 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit.
- 25 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër.
- 15 % e votave të pavlefshme për shkak se janë me shënime që pamundësojnë vlerësimin e votës & favor/disfavor të subjekteve.



- 19 % e votave të pavlefshme janë për arsye të tjera sipas parashikimeve të nenit 117, pika 3 e Kodit Zgjedhor.

Raporti rekomandon marrjen e masave organizative, sanksioneve administrative e bërjen e kallëzimeve penale dhe përmirësime ligjore.

Referuar gjetjeve të verifikimit të pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të dhënave dhe informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes në procesverbalet tip të miratuar me udhëzimin nr. 15/2021 përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore.

Kategoria e parë e informacionit ka të bëjë me saktësinë e shifrave të rezultateve të procesit të vlerësimit të votës për kandidat dhe subjektet zgjedhore. Informacioni është përpunuar në sistem duke identifikuar vlerat për çdo kandidat dhe subjekt dhe diferencën për secilin prej tyre në nivel qendre votimi.

Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave midis votave fizike të gjetura në kuti dhe rezultatet e sistemit PEVN nuk u konstatua asnjë diferencë apo parregullsi.

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë mos gjetjen e asnjë parregullsie, sugjerojmë implementimin e sistemit PEVN në një shkallë më të gjerë në proceset e ardhshme të votimit.

SEKRETARI I PËRSGJITHSHËM

Ylli MERKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Dhjetor 2021

Nr:

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTEVE TË MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES
PASZGJEDHORE TË FLETËVE TË VOTIMIT, MATERIALIT ZGJEDHOR DHE
PAJISJEVE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK (PEVN) TË PËRDORURA
NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, e 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor të 519 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë) qendrave të votimit sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e të dhënave të pajisjeve të votimit elektronik dhe dokumentacionit zgjedhor të zonës së administrimit zgjedhor nr. 40, qarku Tiranë sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. T’i kërkoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj sekretarëve të komisioneve të qendrave të votimit sipas listës në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Të bëj kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga anëtarët e grupeve të numërimit sipas listës në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Data: Dhjetor 2021

Nr.

Për miratimin e raporteve të mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (pevn) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

Nr. ____ prot.

Tiranë më ____ . ____ .2021



Data: Dhjetor 2021

Nr.

Për miratimin e raporteve të mbi gjetjet kyçe të procesit të këqytjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (pevn) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021

LIDHJA 1

RAPORT

MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES TË MATERIALEVE ZGJEDHORE TË PËRDORURA NGA KOMISIONET ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25.04.2021.

HYRJE

Administrata e KQZ-së bazuar në udhëzimin nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, nga datat 14.10.2021 deri më datë 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore.

Këqyrja u krye në përputhje me kërkesat e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Më datë 14.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përzgjedhi në mënyrë rastësore 519 QV që përfaqësonin 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ nga 5199 QV.

Nga kjo listë nuk u përfshinë në përzgjedhjen rastësore QV të sekuestruara nga prokuroria, QV të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor, si dhe QV e KZAZ Nr. 40 të cilat ju nënshtuan procesit të verifikimit të saktësisë së sistemit të votimit dhe numërimit elektronik.

Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 519 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje të cilët vlerësuan dhe administruan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Ky proces përfundoi më datë 02.11.2021 i cili vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.



I. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënat dhe informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes në procesverbalet tip të miratuar me udhëzimin nr. 15/2021 përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore.

Kategoria e parë e informacionit ka të bëjë me saktësinë e shifrave të rezultateve të procesit të vlerësimit të votës për kandidat dhe subjektet zgjedhore. Informacioni është përpunuar në sistem duke indikuar vlerat për çdo kandidat dhe subjekt dhe diferencën për secilin prej tyre në nivel qendre votimi.

Gjatë këtij procesi janë administruar rezultatet e procesverbaleve VPZ-2-NK dhe VPZ-2-NSZ që kanë administruar rezultat e rivlerësimit / rinumërimit për kandidatët e listave shumemërore dhe subjekteve zgjedhore për çdo zonë zgjedhore. Këto procesverbale janë edhe baza e identifikimit të parregullsive.

Kategoria e dytë e informacionit ka të bëjë me plotësimin e një pyetësori shterues dhe shumëdimensional për të vlerësuar performancën dhe përputhshmërinë e zbatimit të detyrave nga ana e komisioneve të nivelit të tretë të administratës zgjedhore.

Nga përpunimi i të dhënave të procesverbalit të verifikimit paszgjedhor model 1 për administrimin zgjedhor (PVZ-1-AZ), janë adresuar 55 pyetje pa përfshirë nënpyetjet që lidhen me pyetjen kryesore.

Pyetjet dhe përgjigjet e tyre janë administruar për të vlerësuar në mënyrë deduktive dhe indikative treguesit e performancës së administratës zgjedhore gjatë ditës së votimit si dhe për të identifikuar proceset që kanë nevojë për t'u përmirësuar më tej.

Identifikimi i problematikave ka përfshirë edhe identifikimin e çështjeve apo situatave që krijuan paqartësi nga zbatimi i Kodi Zgjedhor.

Ky procesverbal shërben si mjeti kryesor për identifikimin e parregullsive përgjatë procesit të administrimit nga administrata zgjedhore.

Më pas të dhënat janë administruar në database dhe janë analizuar në nivel makro duke identifikuar problematikat kryesore dhe vendndodhjen e tyre (KQV konkrete).

Informacioni është kryqëzuar me të dhënat që disponon KQZ (vendimmarrjet e KZAZ për emërimin si anëtarë të KQV / GN) për të identifikuar personat përgjegjës për shkeljet e identifikuara.

II. KONSTATIME DHE PROBLEMATIKA

Në këtë kre janë analizuar dhe janë raportuar në mënyrë sintetike problematikat apo treguesit domethënës

me gjetjet kyçe të këtij procesi.

1) RREGULLSIA E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NGA KQV

Në përgjithësi nga QV-të e këqyrura rezulton se administrata zgjedhore ka përbushur detyrat e saj në nivelin mesatar 79% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore për të duke vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjorë dalë në zbatim të tij.

Problematikat e vërejtura më së shumti kanë të bëjnë me konsistencën e zbatimit të kërkesave procedurale për procesin e administrimit të dokumentacionit të punës së KQV-së, në hapje dhe në mbyllje. Vihet re se vendimmarrjet e KQV-ve nuk janë regjistruar paralelisht në procesverbalet tip të miratuar nga KQZ dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Në 8% të QV janë shënuar raste të dorëheqjes / zëvendësimit të anëtarëve të QV. Ky tregues dëshmon për vulnerabilitetet që mund të krijohen përgjatë procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve dhe është një tregues që lidhet edhe me performancën e përgjithshme të komisioneve të qendrave të votimit.

Procesi i dorëzimit të fletëve të votimit nga KZAZ në KQV dhe pasqyrimi i tyre si në procesverbale edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjes nuk ka ndjekur të njëjtin arsyetim / pasqyrim të dhënash bazuar në procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, respektivisht në kërkesat e neneve 101 dhe 113 të Kodit Zgjedhor.

Rezulton që pasqyrimi i të dhënave dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, mbi numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KZAZ-ja është një nga treguesit më të dobët të performancës së administratës zgjedhore të nivelit të tretë. 39% e QV-ve kanë pasqyruar saktë këto të dhëna në LPM.

Një tregues tjetër që ka shënuar performancë të ulët është edhe përdorimi i listave të zgjedhësve. Lista e zgjedhësve është përdorur në 57 % të rasteve në mënyrë jo konsistente. Kjo situatë ka ardhur edhe për shkak të implementimit të pajisjes së identifikimit elektronik dhe mospërcaktimit të këtij detyrimi në procedurat e vendimit 11 / 2021 të Komisionit Rregullator.

Sipas udhëzimit 11 / 2021 të Komisionit Rregullator, raporti i hapjes dhe i mbylljes i gjeneruar nga pajisja PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe futet në kuti. Administrimi i raporteve të PEI është bërë në mënyrë jo konsistente nga të gjithë KQV-të dhe konkretisht, janë administruar të nënshkruar dhe të



administruar në kuti:

- Në 79 % të QV raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik.
- Në 81% të QV raporti i mbylljes së procesit të identifikimit elektronik.

a) **Administrimi i procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve**

Vendimet e KQV-ve dhe pasqyrimi i tyre në LPM, procesverbalet për administrimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit.

Nenet 41 dhe 42 të Kodit Zgjedhor përcakton detyrat e Sekretarit të KQV-së dhe vendimmarrjet e komisionit të qendrës së votimit, ndërsa nenet 101 – 114 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat dhe rregullat për procesin e votimit ditën e zgjedhjeve.

Të dhënat e përpunuara nga procesverbali që administron pyetjet për këtë tregues tregojnë si mëposhtë:

- 85% e QV kanë marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00.
- Pjesa tjetër referuar edhe kryqëzimit të informacionit nga pajisjet PEI rezulton të jenë hapur me vonesë deri në orën 08.00.
- 81% e QV kanë marrë vendim për mbylljen e votimit në ora 19:00.
- 82% e vendimeve të QV-ve janë të vulosura me vulën e KQV-së.
- Në 2% të QV-ve janë evidentuar vendimmarrje për pezullim të procedurës së votimit dhe në 1% të rasteve është kërkuar ndërhyrja e policisë në QV.
- Në 3% të QV-ve vëzhguesit kanë paraqitur vërejtje.
- Në 3% të QV-ve kanë filluar procedurën e votimit manualisht dhe më pas kanë kaluar me përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit, ndërsa në 2% të QV-ve është evidentuar kalimi i procedurës manualisht për shkak të problematikave të hasura me PEI.
- Në 14% të QV-ve ka shënime për kohën e largimit dhe të kthimit të anëtarëve nga QV.
- Në 3% të QV-ve ka shënime në LPM të rasteve kur zgjedhësi nuk ka pranuar të kryejë verifikimin elektronik, nuk ka depozituar gjurmët e gishtërinjve për tu identifikuar, apo rastet e tentativave për votim dy herë.
- Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit ndodhet në 94 % të QV-ve.
- Procesverbali i hapjes së qendrës së votimit ndodhet në kutinë e votimit në 80% të QV-ve, ndërsa kopje e tij në kutinë e materialeve të votimit është në 75% të rasteve të këqyruara.
- LPM është tërësisht i paplotësuar në 11 QV.



Konkluzion: Nga tërësia e treguesve të performancës së KQV-ve për këtë kategori vendimmarrje, komisionet e qendrave të votimit kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në nivelin mesatar 86% të tyre.

U konstatua se në 11 KQV nuk kanë plotësuar LPM veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Niveli i përputhshmërisë jo domosdoshmërisht përputhet me numrin e Komisioneve të Qendrave të Votimit. Këta të fundit kanë kryer procedurat e marrjes së vendimeve dhe plotësimin e procesverbaleve të administrimit të QV-së dhe Librit të Protokollit të Mbledhjeve sipas përcaktimeve të neneve 36 e vazhdim të Kodit Zgjedhor.

b) **Administrimi i bazës materiale**


Vulat e komisionit të qendrës së votimit dhe vulat me kodet e sigurisë, përdorimi i zarfeve specifike

Administrimi i bazës materiale zgjedhore gjatë ditës së votimit është një tjetër kategori e vlerësimit të performancës së administratës zgjedhore. Në seksionin e pyetjeve të adresuara për mënyrën e administrimit të materialit zgjedhor raportohet kjo situatë:

- Në 93% të QV-ve, janë dorëzuar vulat me kodet e sigurisë me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë.
 - Në 97% të QV-ve numri i kodeve të sigurisë janë të njëjtë me PV (procesverbalin).
 - Në 94% të QV-ve fletët e votimit janë sistemuar në zarfe sipas subjekteve zgjedhore.
 - Në 65% të QV-ve është administruar dokumenti i printuar nga PEI në zarfin “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”.

U konstatua se në 22 QV nuk është administruar Libri i Protokollit të Mbledhjeve.

Në kutinë e materialeve zgjedhore rezultojnë që janë administruar përgjithësisht dokumentat e mëposhtëm nga ana e KQV-së:



Konkluzion: Në mesatarisht 93% të QV-ve baza materiale është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit 11 / 2021 të KQZ-së.

U konstatua se në 21 KQV mungon ky dokument në kutinë e materialeve zgjedhore veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, i cili protokollon ankesat, kërkesat, dhe njoftimet drejtuar KQV-ve, regjistron në LPM vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara, regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie. Në këto kushte në mbështetje të fakteve të evidentuara nga procesi i këqyrjes rezulton se Sekretari i QV-së në këto 21 KQV nuk ka përmbushur kërkesën ligjore.

c) **PV e hapjes dhe e mbylljes së QV-së, raporti i hapjes dhe i mbylljes PEI**

Për herë të parë në këtë proces zgjedhor është implementuar pajisja elektronike e identifikimit. Ky proces synon përdorimin e teknologjisë mbështetëse për identifikimin e zgjedhësve si një mjet alternativ i listës së printuar të zgjedhësve.

Vendimi 11 / 2021 i Komisionit Rregullator ka përcaktuar rregullat që ndiqen nga administrata zgjedhore gjatë procesit të votimit për identifikimin e zgjedhësve.

Nga të dhënat e administruara rezultojnë se :

- Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së, vulosur nga sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së si dhe origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit së bashku me raportin e hapjes së procesit të identifikimit elektronik në zarfin ku është shkruar “ZARF I PROCESVERBALIT TË VULOSJES” ndodhet në kuti në 80 % të QV-ve.
- Raporti i mbylljes së procesit të identifikimit elektronik ndodhet në kuti të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së, vulosur nga sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së dhe është administruar dokumenti i printuar nga PEI në zarfin ku shënohet “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE” në 81 % të QV-ve.
- Në procesverbalin e mbylljes në 79 % të QV-ve është përcaktuar numri i zgjedhësve që kanë votuar, sipas numrit të zgjedhësve të identifikuar elektronikisht në raportin e mbylljes të printuar nga PEI dhe numrin e zgjedhësve femra të identifikuara.
- Në 86 % të QV-ve përputhet numri i fletëve të votimit të papërdorura të mbyllura në zarfin ku është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA” me të dhënat e pasqyruara në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në LPM të KQV-s për fletët e votimit të papërdorura.

Konkluzion: Në, mesatarisht, 82 % të QV-ve janë administruar raportet e identifikimit elektronik të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së e vulosur nga sekretari, janë administruar raportet e hapjes dhe të mbylljes së PEI-t si në kutinë e votimit dhe në kutinë e materialeve zgjedhore.

2) VERIFIKIMI I SAKTËSISË SË NUMËRIMIT TË VOTAVE

KQZ në përputhje me përcaktimet e nenit 167 / 2 të Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimit nr. 15 datë 07.10.2021 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, kreu këqyrjen e saktësisë së vlerësimit dhe numërimit të votave.

Grupet e këqyrjes vlerësuan dhe numëruan votat për subjektet dhe për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore.

Nga këqyrja paszgjedhore në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore rezultuan se:

- 71 % e QV-ve të këqyrura (371 QV nga 519 QV të këqyrura) rezultuan pa diferencë për gjatë procesit të numërimit.
- 28 % e QV-ve të këqyrura (144 QV nga 519 QV të këqyrura) rezultuan me diferencë nga 1-9 vota.
- 1% e QV-ve (4 nga 519 QV) rezultuan me diferencë nga 10-30 vota si më poshtë:

Qendra e Votimit	Diferenca në vota
1189	-10
1877	-29
3557	10
14322	-24
<hr/>	
Total Diferenca	
në vota	-53

Nga procesi i këqyrjes paszgjedhore rezultoi se procesi i numërimit të votave për kandidatët e listave shumëme të subjekteve zgjedhore rezultuan se:

- 83.6 % e QV-ve kanë diferencë nga 1-9 vota (434 QV nga 519 të këqyrura)
- 7.7 % e QV-ve kanë diferencë nga 10-20 vota (40 QV nga 519 të këqyrura)
- 3.7 % e QV-ve kanë diferencë 21 - 80 vota (19 QV nga 519 të këqyrura)
- 5 % e QV-ve nuk kanë diferencë (26 QV nga 519 të këqyrura).

Për shkak të numrit të subjekteve zgjedhore, numërimit të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore është vlerësuar se marzhi i gabimit nga grupet e numërimit të votave për subjektet nuk kanë ndikuar në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve. Ndërkohë ndryshimi i rezultateve nga 1-20 vota për kandidatët është vlerësuar se është një marzh i pranueshëm gabimi njerëzor, referuar edhe standardeve teknike për sa kohe këto diferenca nuk kanë ndikuar në ndryshim domethënës të rezultatit për kandidatë.

Në total janë 18 QV të cilat kanë diferencë nga 21 – 76 vota për kandidatë, si më poshtë:

QV-0150	QV-1650	QV-2780	QV-4390
QV-0161	QV-1877	QV-2796	QV-2044/1
QV-0162	QV-1943	QV-3664	QV-3305/2
QV-0895	QV-2039	QV-4223	QV-4247/1
QV-1532		QV-4383	

a) Votat e pavlefshme dhe natyra e pavlefshmërisë

Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme rezultoi se votat e pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

- 41 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit.
- 25 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër.
- 15 % e votave të pavlefshme për shkak se janë me shënime që pamundësojnë vlerësimin e votës & favor/disfavor të subjekteve.
- 19 % e votave të pavlefshme janë për arsye të tjera sipas parashikimeve të nenit 117, pika 3 e Kodit Zgjedhor.

- fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyre ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ;
- fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi;
- nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
- zgjedhësi ka votuar për një person apo për një subjekt që nuk është në fletën e votimit.

III. REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të referuara edhe në këtë raport, rekomandohet marrja e masave organizative të cilat synojnë rritjen e efikasitetit dhe vendimmarrjes së administratës zgjedhore të nivelit të tretë. Njëkohësisht për shkeljet e konstatuara rekomandohet vijimi i procedurave të mëtejshme administrative për vendosjen e sanksioneve administrative apo kallëzimin e tyre pranë organeve ligjzbatuese për shkeljet e konstatuara.

Rekomandime për përmirësime ligjore:

- Në lidhje me sa më sipër rekomandohet që administrimi i dokumentacionit dhe procesit zgjedhor ditën e votimit të ngarkuara për t'u kryer nga sekretari i KQV-së sipas përcaktimeve të nenit 41 të KZ të bëhet nga personel i rekrutuar dhe i kualifikuar nga KQZ, në bazë të një konkurrimi të hapur dhe jo nga propozime të subjekteve politike.

- Të vendosen kufizime kohore dhe kritere shtrënguese për zëvendësimin e administratës zgjedhore në nivel të dytë dhe të tretë pas trajnimit të tyre.
- Të kërkohet diskrecioni i KQZ-së për të devijuar nga kërkesat ligjore për administrimin manual të dokumentacionit / informacionit në rastin e implementimit të teknologjisë asistuese.
- Të parashikohen dispozita autorizuese për KQZ-në për administrimin në formë elektronike të dokumentacionit për kandidatë të administratës zgjedhore dhe vendimmarrjes së tyre.

Masa organizative:

- Të synohet eficaenca e administratës zgjedhore duke reduktuar volumin e vendimmarrjes dhe miradministruar informacionin kyç për vendimet e KQV-së nëpërmjet rishikimit të akteve që normojnë proceset e punës së administratës të nivelit të tretë.
- Në lidhje me sa më sipër rekomandohet që administrimi i dokumentacionit dhe procesit zgjedhor ditën e votimit të ngarkuara për t'u kryer nga sekretari i KQV-së sipas përcaktimeve të nenit 41 të KZ të bëhet nga personel i rekrutuar dhe i kualifikuar nga KQZ, në bazë të një konkurrimi të hapur dhe jo nga propozime të subjekteve politike.
- Duke marrë në konsideratë aksesueshmërinë e lartë të internetit, mjeteve të komunikimit dhe aplikacioneve mobile, të synohet aplikimi i teknologjisë së informacionit për proceset vendimmarrëse thelbësore të KQV-së dhe raportimi në kohë reale i problematikës zgjedhore.
- Të rishikohen proceset e punës dhe aktet rregullatorë / normative për administratën zgjedhore te nivelit të tretë duke synuar thjeshtëzimin dhe lehtësimin e të dhënave të përpunuara dhe ngritjen e mekanizmave që do të ndikonin në raportimin në kohë reale të tyre.
- Të vendoset një mekanizëm për bllokimin e zëvendësimeve të administratës së nivelit të tretë ditën e zgjedhjeve.

Masa administrative:

- Rekomandohet që grupet e numërimit të votave, sipas aneksit 1 të këtij raporti, për pasaktësitë e konstatuara në pikën 2, të kreut 2, të këtij raporti përbëjnë indicie të besueshme për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 326 paragrafi i parë i Kodit Penal, falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve dhe për këto arsye të bëhet kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor përkatës.
- Në mbështetje të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, rekomandohet që sekretarët e KQV-ve, sipas aneksit 2, të këtij raporti për shkelje të dispozitave të nenit 41 të Kodit Zgjedhor, të propozohet masa administrative më gjobë në masën 30,000 – 60,000 lek.

Aneksi 1

Grupet e numërimit të votave përgjegjëse për shkeljet e konstatuara në kreun II për saktësinë e numërimit të votave për kandidatë:

	QARKU	KODI_QV DHE GRUPI I NUMËRIMIT
1	Berat	33052 1- D.O 2- F.O 3- K.K 4-E.Q
2	Elbasan	2780 1-E.K 2- Y.K 3- O.B 4- E.Z
3	Elbasan	2796 1-D.A 2- E.D 3- M.V 4- O.A
4	Gjirokastër	4247/1 1- A.Ç 2-G.SH 3- S.R 4- A.M
5	Gjirokastër	4383 1-V.B 2- TH.B 3-T.H
6	Gjirokastër	4390 1- P.SH 2-L.H 3- F.M
7	Gjirokastër	4223 1-N.K 2- D.D 3- E.S 4- E.G
8	Korçë	3664 1- A.T 2- K.D 3-E.P 4-E.SH
9	Lezhë	0895 1- A.D 2-F.V 3- F.Gj 4- E.K
10	Shkodër	0162 1- P.K 2- A.M 3- A.T 4- R.D
11	Shkodër	0161 1-IM 2- A.Ç 3- GJ.D
12	Shkodër	0150 1-GJ.V 2-K.Sh 3-E.P 4-S.S
13	Tiranë	2039 1-P.B 2-L.K 3-E.K 4-E.K
14	Tiranë	2044/1 1-LL 2-O.N 3-S.R 4-D.K
15	Tiranë	1650 1-E.M 2-A.T 3-B.G
16	Tiranë	1532 1-A.E 2-E.D 3-E.F
17	Tiranë	1877 1-E.B 2-I palexueshem 3-B.H 4-K.S
18	Tiranë	1943 1-E.H 2- B.N 3-D.D 4- K.L

Gjetjet e grupeve të këqyrjes për diferencat e mëdha për QV për kandidatë:

0150	Zef	Hila	-23			
0161	Zef	Hila	-29			
0162	Zef	Hila	-49			
0895	Rigerta	Loku	24			
1532	Belinda	Balluku	36	Eduard	Shalsi	-76
1650	Et'hem	Aga	31			
1877	Belind	Këlliçi	-29			
1943	Gentjan	Muça	-35			
2039	Asllan	Dogjani	42	Lediana	Fratari	-48
2780	Ardian	Zeneli	31	Lefter	Gështenja	-23
2796	Ardian	Zeneli	38	Lefter	Gështenja	-38
3664	Andrea	Mano	-23			
4223	Bledar	Çuçi	22			
4383	Bledar	Çuçi	-23			
4390	Laert	Duraj	-35			
20441	Korab	Lita	21	Petrit	Doda	22
33052	Blendi	Klosi	27			
42471	Bledar	Çuçi	-29			



Aneksi 2

Gjetjet e këqyrjes për mungesën e LPM / mungesë shënimesh

Nr.	Qarku	KZAZ	QV	LPM
1	Shkodër	1	0027	Jo
2	Shkodër	6	0182	Jo
3	Kukës	11	0616	Jo
4	Kukës	11	0654	Jo
5	Lezhë	14	0891	Jo
6	Lezhë	13	0705	Jo
7	Durrës	23	1493/1	Jo
8	Durrës	20	1322	Jo
9	Durrës	20	1311	Jo
10	Tiranë	33	1771	Jo
11	Tiranë	33	1768/1	Jo
12	Tiranë	30	1603	Jo
13	Tiranë	42	2163	Jo
14	Elbasan	44	2267	Jo
15	Elbasan	44	2265	Jo
16	Fier	55	2876	Jo
17	Berat	66	3451	Jo
18	Korçë	70	3834/1	Jo
19	Vlorë	85	4487/1	Jo
20	Vlorë	87	4571	Jo
21	Vlorë	91	4629	Jo
22	Dibër	17	939	Pa shënime
23	Tiranë	30	1609	Pa shënime
24	Tiranë	29	1536/1	Pa shënime
25	Tiranë	30	2079/2	Pa shënime
26	Elbasan	47	2381	Pa shënime
27	Fier	57	3172	Pa shënime
28	Fier	58	3132	Pa shënime
29	Fier	60	3054	Pa shënime
30	Fier	55	2889	Pa shënime
31	Korçë	72	4023	Pa shënime
32	Vlorë	83	4416	Pa shënime

Nr.	QV	Emër Atësi Mbiemër	Funksioni	Subjekti
1	0027	P.D	Sekretar	PS
2	0616	M.K	Sekretar	PD
3	0654	Z.B	Sekretar	PD
4	0891	E.K	Sekretar	PS
5	0705	A.H	Sekretar	PD
6	1311	B.G	Sekretar	PD
7	1322	P.Z	Sekretar	PD
8	1768/1	P.K	Sekretar	PS
9	1771	R.M	Sekretar	PD
10	2163	M.H	Sekretar	PS
11	2267	L.S	Sekretar	PD
12	2265	B.L	Sekretar	PD
13	2876	G.Xh	Sekretar	PS
14	3834/1	I.D	Sekretar	PD
15	4487/1	E.M	Sekretar	PS
16	4571	A.A	Sekretar	PS
17	4629	M.L	Sekretar	PD
18	0939	E.H	Sekretar	PS
19	1536/1	A.B	Sekretar	PD
20	2381	F.M	Sekretar	PS
21	3172	N.G	Sekretar	PD
22	3132	K.B	Sekretar	PD
23	3054	B.C	Sekretar	PS
24	2889	B.T	Sekretar	PS
25	4023	D.M	Sekretar	PD
26	4416	P.H	Sekretar	PS
27	2079/2	D.S	Sekretare	PS
28	3451	N.K	Sekretar	PS
29	1603	A.S	Sekretar	PS
30	1493/1	N.B	Sekretar	PS
31	0182	S.H	Sekretar	PS
32	1609	L.T	Sekretar	PS



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lidhja 2

RAPORT

MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES TË TË DHËNAE TË PAJISJEVE
ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT (PEVN) 25.04.2021.

HYRJE

Administrata e KQZ-së bazuar në udhëzimin nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, nga datat 14.10.2021 deri më datë 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore.

Këqyrja u krye në përputhje me kërkesat e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së sistemit të votimit dhe numërimit elektronik.

Më datë 14.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi numërimin manual dhe verifikimin e rezultateve të të gjitha qendrave të votimit në KZAZ Nr. 40.

Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 32 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje të cilët vlerësuan dhe administruan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Ky proces përfundoi më datë 02.11.2021 i cili vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti përmbledhës mbi saktësinë e të dhënave të gjeneruara në mënyrë elektronike nga sistemi PEVN me rezultatet nga numërimi i fletëve të votimit të gjetura në kutitë e votimit.



I. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënat dhe informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes në procesverbalet tip të miratuar me udhëzimin nr. 15/2021 përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore.

Kategoria e parë e informacionit ka të bëjë me saktësinë e shifrave të rezultateve të procesit të vlerësimit të votës për kandidat dhe subjektet zgjedhore. Informacioni është përpunuar në sistem duke identifikuar vlerat për çdo kandidat dhe subjekt dhe diferencën për secilin prej tyre në nivel qendre votimi.

II. KONSTATIME DHE PROBLEMATIKA

Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave midis votave fizike të gjetura në kuti dhe rezultatet e sistemit PEVN nuk u konstatua asnjë diferencë apo parregullsi.

III. REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë mos gjetjen e asnjë parregullsie, sugjerojmë implementimin e sistemit PEVN në një shkallë më të gjerë në proceset e ardhshme të votimit.

Lidhja 3**Lista e Sekretarëve të KQV-ve qe nuk kanë administruar/ administruar të paplotësuar tërësisht LPM**

Nr.	QV	Emër Atësi Mbiemër	Funksioni	Subjekti
1	0027	P.D	Sekretar	PS
2	0616	M.K	Sekretar	PD
3	0654	Z.B	Sekretar	PD
4	0891	E.K	Sekretar	PS
5	0705	A.H	Sekretar	PD
6	1311	B.G	Sekretar	PD
7	1322	P.Z	Sekretar	PD
8	1768/1	P.K	Sekretar	PS
9	1771	R.M	Sekretar	PD
10	2163	M.H	Sekretar	PS
11	2267	L.S	Sekretar	PD
12	2265	B.L	Sekretar	PD
13	2876	G.Xh	Sekretar	PS
14	3834/1	I.D	Sekretar	PD
15	4487/1	E.M	Sekretar	PS
16	4571	A.A	Sekretar	PS
17	4629	M.L	Sekretar	PD
18	0939	E.H	Sekretar	PS
19	1536/1	A.B	Sekretar	PD
20	2381	F.M	Sekretar	PS
21	3172	N.G	Sekretar	PD
22	3132	K.B	Sekretar	PD
23	3054	B.C	Sekretar	PS
24	2889	B.T	Sekretar	PS
25	4023	D.M	Sekretar	PD
26	4416	PH	Sekretar	PS
27	2079/2	D.SH	Sekretare	PS
28	3451	N.K	Sekretar	PS
29	1603	A.S	Sekretar	PS
30	1493/1	N.B	Sekretar	PS
31	0182	S.H	Sekretar	PS
32	1609	L.T	Sekretar	PS

Lidhja 4

Grupet e numërimit të votave përgjegjëse për shkeljet e konstatuara në kreun II për saktësinë e numërimit të votave për kandidatë:

	QARKU	KODI_QV DHE GRUPI I NUMËRIMIT
1	Berat	33052 1- D.O 2- F.O 3- K.K 4-E.Q
2	Elbasan	2780 1-E.K 2- Y.K 3- E.Z 4- O.B
3	Elbasan	2796 1-D.A 2- E.D 3- M.V 4- O.A
4	Gjirokastrë	4247/1 1- A.Ç 2-G.SH 3- S.R 4- A.M
5	Gjirokastrë	4383 1-V.B 2- TH.B 3-T.H
6	Gjirokastrë	4390 1- P.SH 2-L.H 3- F.M
7	Gjirokastrë	4223 1-N.K 2- D.D 3- E.S 4- E.G
8	Korçë	3664 1- A.T 2- K.D 3-E.P 4-E.SH
9	Lezhë	0895 1- A.D 2-F.V 3- F.GJ 4- E.K
10	Shkodër	0162 1- P.K 2- A.M 3- A.T 4- R.D
11	Shkodër	0161 1-I.M 2- A.Ç 3- Gj.D
12	Shkodër	0150 1-Gj.V 2-K.Sh 3-E.P 4-S.S
13	Tiranë	2039 1-P.B 2-L.K 3-E.K 4-E.K
14	Tiranë	2039/1 1-E.Gj 2-L.B 3-A.I 4-G.L
15	Tiranë	2044/1 1-I.L 2-O.N 3-S.R 4-D.K
16	Tiranë	1650 1-E.M 2-A.T 3-B.G
17	Tiranë	1532 1-A.E 2-E.D 3-E.F
18	Tiranë	1877

		1-E.B 2- I PALEXUESHEM 3-B.H 4-K.S
19	Tiranë	1943 1-E.H 2- B.N 3-D.D 4- K.L